


Tregtia me pakicë

Tremujori I 2022

Tiranë, më 15 Qershor: Në tremujorin e parë 2022, indeksi i volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë shënoi 108,8. Shitjet në volum në tregtinë me pakicë janë rritur 5,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Krahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i përshtatur sezonalisht është rritur 1,0 %.

Fig. 1 Indeksi i volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë, (i papërshtatur sezonalisht)



Ndryshimi vjetor në indeksin e volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë

Në tregtinë me pakicë, pa përfshirë këtu tregtinë me pakicë të hidrokarbureve, volumi i shitjeve në tremujorin e parë 2022 është rritur me 5,5 %, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2021.

Në grupin “Ushqime, pijë, duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara”, volumi i shitjeve është rritur 4,7 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2021.

Volumi i shitjeve, për grupin “Artikuj jo-ushqimorë në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara”, është rritur 6,2 %, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit paraardhës.

Në grupin “Tregti hidrokarbure në njësi tregtare të specializuara”, volumi i shitjeve është rritur me 4,2 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2021.

Për publikim 15/06/2022


Vijon

Ndikimi i grupeve në tregtinë me pakicë

Në ndryshimin vjetor prej +5,2 %, në tremujorin e parë 2022 ndaj tremujorit të parë 2021, në tregtinë me pakicë, grupet kanë kontribuar si më poshtë:

“Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara” me +2,6 pikë përqindje dhe grupi “Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara” me +1,3 pikë përqindje. Grupi “Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara” ka kontribuar me +1,3 pikë përqindje.

Fig. 2 Kontributi i degëve kryesore të Tregtisë me Pakicë në normën reale të mitjes (t1_2022 / t1_2021).



Ndryshimi tremujor në indeksin e volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë, i përshtatur sezonalisht

Në tremujorin e parë 2022, volumi i shitjeve, përshtatur sezonalisht, në grupin “Tregti me pakicë, pa përfshirë këtu tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara”, është rritur me 0,2 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Në grupin “Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara”, volumi i shitjeve, përshtatur sezonalisht, është rritur me 0,8 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Volumi i shitjeve, përshtatur sezonalisht, në tregtinë me pakicë, për grupin “Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara”, është rritur me 0,1 %, kundrejt tremujorit të mëparshëm.

Në grupin “Tregti me pakicë hidrokarbure në njësi tregtare të specializuara”, volumi i shitjeve, i përshtatur sezonalisht, është rritur me 1,8 %, kundrejt tremujorit të katërt 2021.

Tab. 1 Ndryshimi vjetor i indeksit të shitjeve neto në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të Hidrokarbureve (papërshtatur sezonalisht)

NVE Rev. 2	Aktiviteti Ekonomik	I.21 / I.20	II.21 / II.20	III.21 / III.20	IV.21 / IV.20	I.22 / I.21	%
47	Tregti me Pakicë	3,6	9,9	4,9	4,4	5,2	
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	1,3	5,5	3,3	3,7	5,5	
4711;472	Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara	-1,9	-1,2	2,1	4,0	4,7	
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	3,5	10,9	4,2	3,6	6,2	
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	11,0	23,9	10,3	6,0	4,2	

Tab. 2 Ndryshimi tremujor i indeksit të shitjeve neto në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (përshtatur sezonalisht)

NVE Rev. 2	Aktiviteti Ekonomik	I.21 / IV.20	II.21 / I.21	III.21 / II.21	IV.21 / III.21	I.22 / IV.21	%
47	Tregti me Pakicë	-3,4	-0,3	6,9	1,4	1,0	
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	-5,5	-0,4	7,6	2,4	0,2	
4711;472	Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara	-3,0	0,0	3,1	3,9	0,8	
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	-4,7	-0,7	9,1	0,3	0,1	
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	4,9	-2,3	9,1	-5,2	1,8	

Tab. 3 Ndryshimi vjetor i indeksit të shitjeve neto në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve, sipas muajve (papërshtatur sezonalisht)

NVE Rev. 2	Aktiviteti Ekonomik	01-22 / 01-21	02-22 / 02-21	03-22 / 03-21	%
47	Tregti me Pakicë	7,1	7,9	1,2	
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	6,4	7,5	3,1	
4711;472	Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara	4,7	7,7	2,0	
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	7,6	7,5	3,9	
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	8,8	9,0	-3,9	

Tab. 4 Ndryshimi më i madhi i indeksit të shitjeve neto në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve, sipas muajve (përshtatur sezonalisht)

NVE Rev. 2	Aktiviteti Ekonomik	01-22 / 12-21	02-22 / 01-22	03-22 / 02-22	%
47	Tregti me Pakicë	-0,5	0,9	-1,8	
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	-2,6	1,9	-1,3	
4711;472	Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara	-1,3	1,0	-0,9	
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	-2,0	3,1	-1,0	
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	2,1	-0,7	0,6	

Tab. 5 Indekset mujore në vlerë dhe volum në tregtinë me pakicë (papërshtatur sezonalisht)

Grup 47										2015=100
NVE Rev. 2	2019		2020		2021		2022			
	Viti	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	
Muaji	1	102,3	98,8	118,2	113,3	100,0	98,4	115,0	105,4	
	2	100,1	96,3	109,4	104,6	101,6	98,7	118,5	106,4	
	3	110,0	105,9	85,7	81,7	117,4	113,3	133,9	114,6	
	4	109,0	104,9	78,9	76,1	107,5	103,4			
	5	114,7	111,3	105,6	103,3	115,7	111,3			
	6	117,1	113,8	124,8	123,2	121,6	117,6			
	7	126,3	123,1	127,3	126,4	134,1	128,4			
	8	137,7	134,0	127,8	126,8	149,3	142,2			
	9	119,6	116,2	124,0	122,6	130,1	123,7			
	10	119,5	116,2	118,6	117,3	129,9	122,1			
	11	117,7	114,5	118,6	117,6	129,5	121,1			
	12	143,6	139,0	146,5	144,4	164,1	152,6			

Tab. 6 Indekset mujore në vlerë dhe volum në tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (papërshtatur sezonalisht)

2015=100									
NVE		Grup 4730							
Viti	2019		2020		2021		2022		
Muaji	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	
1	97,0	98,1	111,5	112,0	83,3	95,1	109,5	103,5	
2	86,3	87,2	91,8	92,5	82,3	92,0	110,1	100,3	
3	98,2	98,7	59,1	62,1	98,1	108,9	130,4	104,6	
4	97,1	97,1	55,8	60,6	88,4	97,9			
5	102,5	102,6	74,7	82,5	97,0	104,1			
6	109,3	109,6	98,4	109,6	103,9	111,1			
7	120,7	121,2	104,8	117,3	122,3	126,0			
8	138,3	138,8	109,1	121,8	145,4	148,7			
9	109,5	110,0	101,3	113,2	111,4	113,9			
10	109,3	109,7	94,9	107,2	116,2	114,2			
11	101,2	101,6	86,2	97,8	107,8	103,1			
12	113,8	114,2	96,1	108,8	122,1	115,5			

Metodologjia

Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave të Tregtisë me Pakicë me statistikat evropiane, INSTAT publikon Indeksin e volumit në Tregtinë me Pakicë si më poshtë:

- Indekset në Tregtinë me pakicë dhe Tregtinë dhe riparimin e automjeteve llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Tremujore në Tregtinë me Pakicë e Tregtinë dhe Riparimin e Automjeteve, për vitin 2018, realizuar nga INSTAT, Shifra e afarizmit është vlerësuar në nivel produkti, Për kodifikimin e produkteve është përdorur Nomenklatura e Produkteve (NP).
- Grupet kryesore të detajimit janë në përputhje me grupet koresponduese në Indeksin e Çmimeve të Konsumit.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat tremujore të Tregtisë me pakicë pranë ndërmarrjeve tregtare përshkruajnë ecurinë dhe zhvillimet më të fundit të treguesve ekonomik në njësitë e shitjes me pakicë dhe konsumit të popullatës në vend.

Baza ligjore të cilës i nënshtronhet metodologjia e prodhimi të treguesve të Tregtisë me Pakicë, është rregullorja e Këshillit Evropian numër 1165/98, 19 Maj 1998, e rishikuar, mbi Statistikat Afatshkurtra.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor janë përfshirë në vrojtim:

- ndërmarrjet e tregtisë me pakicë gruji 47-NVE Rev.2 (përjashto 47,79-4799)
- tregtia me pakicë e hidrokarbureve gruji 473-NVE Rev. 2

Grupet janë vlerësuar në bazë të përqindjes që secili produkt ose mall ka zenë në shifrën gjithsej të afarizmit të realizuar nga ndërmarrjet, Për kodifikimin e produkteve është përdorur Nomenklatura e Produkteve (NP), Grupet kryesore të detajimit janë në përputhje me grupet përkuese në Indeksin e Çmimeve të Konsumit, Indekset krahasohen me periudhën bazë, 2015=100.

Peshat – Struktura e peshave në Tregtinë me Pakicë:

Ushqime, pijë e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara 31,9 %

Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara 44,0 %

Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara 24,1 %

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 4 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 5 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Për këtë tremujor është përdorur burimi administrativ dhe intervistim të drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve nga anketuesit.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi tremujor në përqindje, ndryshimi vjetor në përqindje me një vit referues bazë, aktualisht $2015=100$, Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variabash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres, Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indeksin e çmimeve të konsumit për periudhat përkatëse sipas grupeve përkuese.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njejtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njejitit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsyet: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

Përkufizim i treguesit kryesor - Shifra e afarizmit përfshin shitjet mujore gjithsej që ndërmarrja realizon gjatë muajit nga shitja e produkteve apo shërbimeve përjashtuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

Përshtatja sezonale dhe kalendarike

Përshtatja sezonale dhe kalendarike në seritë mujore / tremujore të Tregtisë me pakicë u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2,2. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori I 2022, Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në serinë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit, komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale dhe kalendarike në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Për përshtatjen kalendarike është përdorur specifikimi i ditëve tregtare dhe kalendari kombëtar, duke marrë në konsideratë si festat fiksë dhe ato të lëvizshme.

Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e vecanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.